VENDIM
Nr. 769, datë 20.12.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI III (SHTESA)"

(ndryshuar me VKM-në nr. 867, datë 27.12.2022)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, loti III (shtesa)".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 491 309 103 (katërqind e nëntëdhjetë e një milionë e treqind e nëntë mijë e njëqind e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 491 309 103 (katërqind e nëntëdhjetë e një milionë e treqind e nëntë mijë e njëqind e tre) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) 445 657 671 (katërqind e dyzet e pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë përballohen nga llogaria e veçantë për shpronësimet, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

b) 45 651 432 (dyzet e pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", "Vërtetim hipotekor", "Certifikatë pronësie", të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

LISTA E SHPRONËSIMEVE QË PREKEN NDA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI III (SHTESAT)"

ANA E MAJTË									
Nr.	**Emri**	**Atësia**	**Mbiemri**	**Zona kadastrale**	**Numri i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Sip. (m^2) Shpronësimit**	**Çmimi në lekë/m^2**	**Vlera**
1	Laim	Qemal	Kamberaj	8170	7/671	Truall	300	32,878	9,863,400
2	Laim	Qemal	Kamberaj	8170	7/356	Ndërtesë	281.7	90,000	25,353,000
3	Bp, Bollati, Gega, Mara, Geca			8170	10/31	Truall	809.77	32,878	26,623,618
4	Bp, Tabaku, Elezi			8170	7/683	Truall	1947	32,878	64,013,466
5	B.p. Bebri			8170	8/665	Truall	119.9	32,878	3,942,072
6	B.p. Bebri			8170	8/665	Ndërtesë	120	90,000	10,800,000
7	Hamid	Mehmet	Myftari	8170	9/111	Ndërtesë	133	90,000	11,970,000
8	Beqir	Banush	Matuka	8170	7/572/ND	Ndërtesë	92.66	90,000	8,339,400
9	Ferid		Domi	8170	9/130-ND	Ndërtesë	58	90,000	5,220,000
10	Ramiz	Mustafa	Myrty	8170	9/291-ND	Ndërtesë	129	90,000	11,610,000
11	Xhavit	Avdi	Balliu	8170	9/410-ND	Ndërtesë	214	90,000	19,260,000
12	BAU Konstruksion			8170	9/609	Truall	1924	32,878	63,257,272
								SHUMA 1	**260,252,228**
ANA E DJATHTË									
1	Agush	Sulo	Karameto	8180	2/25	Truall	300	31,270	9,381,000
2	Agush	Sulo	Karameto	8180	2/25-ND	Ndërtesë	87.9	110,000	9,669,000
3	Bashkëpronarët Tabaku			8180	6/295	Truall	1289	31,270	40,307,030
4	Vasil	Mihal	Stamati	8180	3/566	Truall	215	31,270	6,723,050
5	Fatmir	Dilaver	Nazifi	8180	3-4/ND	Ndërtesë	133	110,000	14,630,000
6	B.p. Basha, Taka, Luli, Agaj			8180	6/73+1-1	Apartament	57.3	110,000	6,303,000
7	Erion	Mahmut	Fusha	8180	7/597	Truall	350	31,270	10,944,500
8	Erion		Fusha	8180	7/597	Ndërtesë	47.4	110,000	5,214,000
9	Fatbardha, Fation (b.p.)		Fusha	8180	7/646	Truall	391.9	31,270	12,254,713
10	B.p. Fatbardha, Fation		Fusha	8180	7/646	Ndërtesë	357	110,000	39,215,000
11	Bedri	Mersin	Koci	8180	7/559-ND	Ndërtesë	99	110,000	10,890,000
12	Gani		Hidri	8180	7/80	Ndërtesë	99	110,000	10,890,000
13	Liri		Masha	3976	213/30/ND-2	Ndërtesë	63.2	66,500	4,202,800
14	Refat		Karaj	3976	213/30-ND	Ndërtesë	71.9	66,500	4,781,350
								SHUMA 2	**185,405,443**
								TOTAL (1+2)	**445,657,671**

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 769, DATË 20.12.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI III (SHTESA)"'

(shtuar me VKM-në nr. 867, datë 27.12.2022)

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM									VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
												ARË			TRUALL			NDËRTESË				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m^2)	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)		
	A	*B*	*C*	*Ç*	*Ç*	*D*	*E*	*F*	*G*	*H*	*I*	*L*	*M*	*N*	*O*	*P*	*Q*				*Y*	*Z*
1	Vjollca Avni Myzejen Alime	Hajdar Hajdar Hajdar	Alla Qosja Miccolis Qosja	TIRANË	3976	155/50	ARE	1180	1180			334	448	149,632							149,632	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Sadik	Murat	Luga	TIRANË	8180	7/634	Truall	1500		1500					1,340	31,270	41,901,800				41,901,800	Konfirmuar nga ASHK
3	Adriana Donald	Muharrem Bexhet	Gega Gega	TIRANË	8170	8/523	Truall	520		520	85							40	90,000	3,600,000	3,600,000	Konfirmuar nga ASHK-ja. Shpronësuar për truallin në VKM-në nr. 557, datë 27.5.2016
Vlera totale																					45,651,432	